DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-502/4
01
Data Datum 15.05.2018

# Republika Kosovo - Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës<br>Bexhet Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Minister i MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Shkëlqim Jakupi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL | Datë: 10/05/2018 |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës se Suharekës | Nr. 020-502 |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim | |

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim 01 Nr.016/20280 dhënien e pëlqimit për zhvillimin e procedurave përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelës nr. 2785/3, 2785/5, 2785/20, 2785/63 dhe 2785/66 pasuri shoqërore në emër të komunës se Suharekës |
| I miratuar më datë: 26.04.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.04.2018 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural ***është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi***. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-502/4
15.05.2018

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | Bali Muharremaj, gradonačelnik Opštine Suva Reka<br>Bexhet Kuçi, predsedavjući Skupštine opštine Suva Reka | |
| Cc: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MALS-a<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, | |
| Od: | Skëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština /MALS | Datum: 10.05.2018 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Suva Reka | Br. 020-502 |
| Vrsta odluke: | Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka 01 br- 016-20280 za davanje saglasnosti za razvijanje procedura preko otvorenog konkursa za davanje na dugoročno korišćenje parcela sa br. 2785/3, 2785/5, 2785/20, 2785/63 i 2785/66 kao prirodno bogatstvo u ime opštine Suva Reka |
| Usvojena dana, 26.04.2018. godine, |
| Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 30.04.2018. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je sa proceduralnog aspekta isti u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministartsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligji Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008", nenëve 15, 29, pika 2 te Statutit të Komunës së Suharekës, 01 Nr 8336, i datës 04.11.2008, nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, të Ligjit Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 35/20[illegible] mbështetje të nenit 5, lidhur me nenin 11, të Rregullores QRK, Nr 23/[illegible] përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të [illegible] paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e [illegible] datë, 26.04.2018, miraton këtë:

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 30.04.2018
Njësia organizative: VI - | Nr. i Lëndës: 020-502 | Shtojca | Vlera

VENDIM

Neni 1

**JEPET PËLQIMI**-për të zhvilluar procedurën përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15, (pesëmbëdhjetë) deri në 99, (nëntëdhjetë e nëntë) vjet të pronës së paluajtshme të Komunës si më poshtë:

1. **Parcela,** kadastrale, **Nr-2785/3** me sipërfaqe prej **4046m²** me destinim sipas planit rregullativ **"Veprimtari administrativ"**, pasurisë shoqërore në emër të Komunës e Suharekës.

2. **Parcela,** kadastrale, **Nr-2785/5** me sipërfaqe prej **1401m²**, me destinim sipas planit rregullativ **"Veprimtari administrativ"**, pasurisë shoqërore në emër të Komunës e Suharekës.

3. **Parcela,** kadastrale, **Nr-2785/20** me sipërfaqe prej **8000m²**, me destinim sipas planit rregullativ **"Depo te ndryshme materiale"**, pasurisë shoqërore në emër të Komunës e Suharekës.

4. **Parcela,** kadastrale, **Nr-2785/63** me sipërfaqe prej **5000m²**, me destinim sipas planit rregullativ **"Përpunimi i elementeve nga materiale i plastikës, aluminit dhe drurit"**, pasurisë shoqërore në emër të Komunës e Suharekës dhe

5. **Parcela,** kadastrale, **Nr-2785/66** me sipërfaqe prej **5000m²**, me destinim sipas planit rregullativ **"Përpunimi i elementeve nga materiale i plastikës, aluminit dhe drurit"**, pasurisë shoqërore në emër të Komunës e Suharekës.

Neni 2

**OBLIGOHET**-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtra dhe afatgjatë, që të zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.35/2012" dhe të Rregullores QRK, Nr.23/2015, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dorëzimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK) Nr-01/2016 për rishqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S - S U H A R E K Ë

01-Nr-016-20280
Më datë 26.04.2018

Kryesuesi i Kuvendit

Besnik RAÇI